

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 5157 REP.

VERTETIM
i njesise me dokumentin origjinal

Sot me date 16/10/2018 (dymije e tetembedhjete), para meje noteres Ridvana Ruçi, me adrese ne Tirane, Rruga "Kajo Karafili, u paraqit personalisht:

Ana Goro, me atesi Mihal dhe amesi Vasilika, e datelindjes 03.03.1985, me banim Tirane, mbajtese e dokumentit te identifikimit me numer personal. I55303082E, madhore me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

E cila me kerkoi te vertetoj me origjinalin fotokopjen e dokumentit:


"Kontrate e blerjes se kuotave lidhur me date 01 gusht 2018 me pale shitese Wildermore Holding ltd dhe pale blerese Inform P.Lykos Processing & Deleopment of Printed Information Systems."

Une Noterja (pasi I bera te qarte personit te mesiperm pergjegjesine penale, ne rast paraqitje dokumentit te rreme), ne baze te nenit 56 te Ligjit nr.7829, date 01.06.1994 "Per Noterine" dhe Udhezimit te Ministrit te Drejtesise Nr.6291, date 17.08.2005, pika 3,4 dhe 7, vertetoj qe fotokopja e paraqitur eshte e njejte me dokumentin origjinal.



NOTERE

RIDVANA RUÇI



SHARE PURCHASE AGREEMENT

AUGUST 1ST, 2018

Annexes:

- Annex 1: Extract of ADPS issued by the Albarian Business Centre
- Annex 2: ADPS' Resolution on the transfer of 1 Sale Share
- Annex 3: Seller's Resolution on the transfer of 1 Sale Share
- Annex 4: Purchaser's Resolution on the transfer of 1 Sale Share


- 
- III. WH intends to sell and the Purchaser intends to purchase the share owned by WH having a value of Albanian Lek 24.50 ("Sale Share") in the share capital of the Company.
- IV. The Seller wishes to sell the Sale Share and the Purchaser wishes to purchase the Sale Share pursuant to the terms and conditions set forth in this share purchase agreement (the "Agreement" or "SPA");
- V. Upon the transfer of the ownership over the Sale Share, the Shareholders of the Company and the Shares held by them will be as follows:
1. **INFORM P. LYKOS S.A. PROCESSING & DEVELOPMENT OF PRINTED INFORMATION SYSTEMS**, an anonymous Greek Company (société anonyme), duly registered under General Commercial Registry number 359201000, with registered address at Koropi, 5th km Varis - Koropiou Avenue, Greece, shall own 75.50 % (seventy five and a half per cent) of the share capital of the Company; and
 2. **ALBDESIGN PSP**, an Albanian limited liability company, registered under the laws of Republic of Albania, with registration number NUIS L51819005Q and registered address Rr. Cerciz Topulli, Nr 17, Kashar, Tirana – Albania, shall own 24.50 % (twenty four and a half per cent) of the share capital of the Company

In consideration of the above, THE PARTIES AGREE as follows:

ARTICLE 1 DEFINITIONS

In addition to the other terms defined elsewhere in this Agreement, for the purpose of it, the following words and terms shall have the meaning set forth below:

- "Accounts" means the Company's audited financial statements prepared in accordance with Albanian legislation for the financial year ended on the 31.12.2017;
- "Agreement" means this Share Purchase Agreement - including, as an integral part thereof, the above recitals and the attached annexes - executed and exchanged by and between Purchaser and the Seller;
- "Albanian State" or "Albania" means the Republic of Albania;



“Last Accounting Date”	means 31.12.2017;
“Loss” or “Losses”	means any damage, cost, incurred expenses, payment, loss or liability, which are a direct or indirect consequence of the breach of this Agreement, in particular any of the representation and warranties specified in Article 5;
“Party” or “Parties”	means the Purchaser, as defined herein, or the Seller or both, as the context may require;
“Purchase Price”	means EUR 217,000.00 (two hundred seventeen thousand Euro) for the purchase of the Sale Share as indicated in Article 3 and in accordance with the mechanism set out therein;
“Transfer Date”	means the date the Share Purchase Agreement is registered with the Albanian National Registration Centre and the ownership over the Sale Share is transferred from the Seller to the Purchaser;
“Sale Share”	means 1 ordinary share, as defined at Whereas III.;
“Signing”	means the signing of this Agreement;
“Signing Date”	means the date this Agreement is signed between the Parties;
“Transaction Documents”	mean this Agreement, and any other amendment or annexes and schedules hereto or thereto.

- 1.1 The masculine gender shall include the feminine and neuter and the singular number shall include the plural and vice versa.
- 1.2 References to “persons” shall include corporate bodies, unincorporated associations and partnerships (whether or not having separate legal personality).
- 1.3 References in this Agreement to clauses and annexes are to clauses and annexes to this Agreement (unless the context otherwise requires). The annexes to this Agreement shall be deemed to form an integral part of this Agreement.
- 1.4 Headings are inserted for convenience only and shall not affect the interpretation of this Agreement.

The Parties shall cooperate and shall cause the Company to cooperate with the Purchaser, or to act directly where necessary or requested by any applicable law, in the preparation of the required filing(s).

ARTICLE 5

REPRESENTATIONS AND WARRANTIES OF THE SELLER

The Seller hereby makes the following representations and warranties to the Purchaser, each of which shall be true and correct on the Completion Date.

5.1. ORGANISATION

The Seller is not insolvent and has full power to conduct its business as presently conducted and to own its assets and properties as presently owned..

5.2. AUTHORISATION

All corporate acts and/or other proceedings required to be taken by or on behalf of the Seller to authorise the same to enter into and to carry out this Agreement have been properly taken, this Agreement has been duly executed and delivered by the Seller and constitutes a valid and binding obligation of the Seller enforceable against it, in accordance with its terms and conditions.

5.3. NO CONFLICT

The execution and delivery of this Agreement do not - and the completion of the transactions contemplated by this Agreement and the compliance with the terms, conditions and provisions of this Agreement by Seller will not - conflict with or result in any violation or default under, or result in breach of any law or other document of the Seller that may affect the validity or enforceability of this Agreement.




ARTICLE 6

REPRESENTATIONS AND WARRANTIES OF THE PURCHASER

The Purchaser hereby makes the following representations and warranties to the Seller, each of which shall be true and correct on the Completion Date.

6.1. ORGANISATION

The Purchaser is not insolvent and has full power to conduct its business as presently conducted and to own its assets and properties as presently owned. The Purchaser shall be liable for the payment of the Purchase Price as defined under the Article 3.



- a) By mutual written agreement between the Seller and the Purchaser as of the date provided for therein; or
- b) In the event that the Purchaser fails to pay the Purchase Price, in compliance with Article 3 above, except otherwise agreed between the Parties; or
- c) The Parties failing to obtain any Governmental Approvals (if mandatory required) within 180 days ("**Longstop Date**") for reasons not attributable to them, unless they decide in written to postpone such date.

ARTICLE 9 GOVERNING LAW AND JURISDICTION

This Agreement is governed by the laws of Albania.

Any disputes arising in connection with validity, effectiveness, interpretation enforcement and termination of this Agreement shall be settled by the Albanian competent court.

NOTAR
TIRANE

ARTICLE 10 MISCELLANEOUS

10.1. AMENDMENTS

No amendment, modification, termination or waiver of any provision of this Agreement shall in any event be effective unless the same will be in writing, signed by or on behalf of each Party and notarized.


10.2. SEVERABILITY

In case any provision in or obligation under this Agreement shall be invalid, illegal or unenforceable in any jurisdiction the validity, legality and enforceability of the remaining provisions or obligations, or of such provision or obligation in any other jurisdiction, shall not in any way be affected or impaired thereby.

The Parties hereby agree to attempt to substitute for any invalid or unenforceable provision which, to the greatest extent possible, achieves the purposes of the invalid or unenforceable provision.

10.3. COUNTERPARTS

This Agreement may be executed in one or more counterparts, each of which when so executed and delivered shall be deemed an original, but all such counterparts together shall constitute but one and the same instrument; signature pages may be detached from multiple



THE PURCHASER:

Ms Alexandra Adam

Address: 5th km Varis - Koropiou Avenue
19400 Koropi, Greece

Phone: +302106697559

Mobile: +306936697559

E-mail: a.adam@lykos.gr

10.5. ASSIGNMENT

This Agreement shall be binding on and inure to the benefit of the Parties and their successors and permitted assigns.


The Parties may not assign and transfer any of its rights under this Agreement in whole or in part without the prior written consent of the other Party, consent that shall not be unreasonably withheld.

10.6. COST AND TAXES

Except where this Agreement provides otherwise, each Party shall pay its own costs and taxes relating to the negotiation, preparation, signing and execution of this Agreement and any annexes thereto.

10.7 ENTIRE AGREEMENT

This Agreement constitutes the entire agreement and supersedes any previous agreement between the Parties relating to the subject matter of this Agreement.



KONTRATË E BLERJES SË KUOTAVE



1 GUSHT 2018

Anekset:

- Aneksi 1: Ekstrakti ADPS-së lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit në Shqipëri
- Aneksi 2: Vendimi ADPS-së mbi transferimin e 1 Kuote në Shitje
- Aneksi 3: Vendimi Shitësit mbi transferimin e 1 Kuote në Shitje
- Aneksi 4: Vendimi Blerësit mbi transferimin e 1 Kuote në Shitje

KONTRATË E BLERJES SË KUOTAVE



Sot, më 1 Gusht 2018, përfaqësuesit ligjorë të palëve të mëposhtme lidhën dhe nënshkruan këtë kontratë të blerjes së kuotave:

- **Wildermore Holdings Ltd.**, një Shoqëri e regjistruar sipas ligjeve të Ishujve të Virgjër Britanikë më 26 Tetor 2011, me numrin e shoqërisë 1677588 dhe me zyrë të regjistruar në Geneva Place, Waterfront Drive, P.O. Box 3469, Road Town, Tortola, Ishujt e Virgjër Britanikë, përfaqësuar në mënyrë të rregullt nga KPK TRUSTEES Ltd, ne cilesine e drejtorit të shoqërisë, përfaqësuar nga Znj. Maria Kannava

(tani e tutje referuar si “WH” ose “Shitësi”)

- **INFORM P. LYKOS S.A. PROCESSING & DEVELOPMENT OF PRINTED INFORMATION SYSTEMS**, një Shoqëri anonime greke, e regjistruar rregullisht në regjistrin tregtar me numër 359201000, me adresë të regjistruar në Koropi, kilometri 5-të Varis – Koropiou Avenue, Greqi, përfaqësuar në mënyrë të rregullt nga Znj. Alexandra Adam

(tani e tutje referuar si “Blerësi”)

DUKE QENË SE:

- I. **Albanian Digital Printing Solutions & Services Sh.p.k.**, është një shoqëri shqiptare e themeluar rregullisht, regjistruar më 18.03.2011 në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në Shqipëri, me numër unik identifikimi tatimor (NIPT) L11518003F, me adresë në Autostradën Tiranë-Durrës, Kilometri 5-të, Shqipëri (“ADPS” ose “Shoqëria”) me kapital aksionar 100.00 Lekë (njëqind lekë), të ndarë në 3 (tre) kuota secila me një vlerë të ndryshme, të shpërndara përgjatë tre ortakëve të Shoqërisë;
- II. Shitësi dhe Blerësi janë respektivisht Ortakët e Shoqërisë dhe Kuotat e zotëruara prej tyre janë si më poshtë:
 - **Wildermore Holdings Ltd.**, është ortak dhe përfitues i 1 kuote, me një vlerë prej 24.50 (njëzet e katër pikë pesë) Lekë.
 - **INFORM P. LYKOS S.A. PROCESSING & DEVELOPMENT OF PRINTED INFORMATION SYSTEMS**, është ortak dhe përfitues i 1 kuote, me një vlerë prej 51.00 (pesëdhjetë e një) Lekë;
- III. WH synon të shesë dhe Blerësi synon të blejë kuotën e zotëruar nga WH me vlerë 24.50 Lekë (“**Kuota në Shitje**”) në kapitalin aksionar të Shoqërisë.

IV. Shitësi dëshiron të shesë Kuotën në Shitje dhe Blerësi dëshiron të blejë Kuotën në Shitje sipas kushteve dhe afateve të përcaktuar në këtë kontratë të blerjes së kuotave (“**Kontrata**” ose “**KBK**”);

V. Pas transferimit të pronësisë mbi Kuotën në Shitje, Ortakët e Shoqërisë dhe Kuotat e zotëruara prej tyre do të jenë si më poshtë:

1. **INFORM P. LYKOS S.A. PROCESSING & DEVELOPMENT OF PRINTED INFORMATION SYSTEMS**, një Shoqëri anonime greke, e regjistruar regullisht në Regjistrin e Përgjithshëm Tregtar me numër 359201000, me adresë të regjistruar në Koropi, kilometri 5-të Varis – Koropiou Avenue, Greqi, do të zotërojë 75.50% (shtatëdhjetë e pesë pikë pesë) të kapitalit aksionar të Shoqërisë; dhe
2. **ALBDESIGN PSP**, një shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me numër regjistrimi NIPT L51819005Q dhe adresë të regjistruar në Rr. Cerciz Topulli, Nr. 17, Kashar, Tiranë – Shqipëri, do të zotërojë 24.50% (njëzet e katër pikë pesë) të kapitalit aksionar të Shoqërisë

Në konsideratë të sa më sipër, PALET BIEN DAKORT si më poshtë:

NENI 1 PËRKUFIZIME

Përvec termave të përkufizuar diku tjetër në këtë Kontratë, për qëllim të saj, fjalët dhe termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin e përcaktuar më poshtë:

“Llogari”	nënkupton pasqyrat financiare të audituara të Shoqërisë të përgatitura në përputhje me legjislacionin shqiptar për vitin financiar të përfunduar më 31.12.2017;
“Kontratë”	nënkupton këtë Kontratë të Blerjes së Kuotave – duke përfshirë, si një pjesë integrale të saj, përshkrimet e mësipërme dhe anekset bashkëlidhur – nënshkruar dhe shkëmbyer nga dhe midis Blerësit dhe Shitësit;
“Shteti Shqiptar” ose “Shqipëria”	nënkupton Republikën e Shqipërisë
“Biznes”	nënkupton të gjitha shërbimet e Shoqërisë që mund ti ofrohen klientëve të saj, sikundër mund të kërkojë konteksti;

“Ligji Tregtar”

nënkupton Ligjin nr. 9901, datë 14 Prill 2008 “Mbi Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar;

“Shoqëria”

nënkupton Albanian Digital Printing Solutions sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar rregullisht më 18.03.2011 dhe ligjërisht ekzistuese sipas ligjit shqiptar, me zyrë të regjistruar në Tiranë, me kapital aksionar prej 100.00 Lekë (njëqind lekë);

“Data e Mbylljes”

nënkupton datën në të cilën kjo Kontratë do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Shqipëri dhe Blerësi do të regjistrohet me sukses në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Shqipëri si ortak i Kuotës në Shitje;

“Barre”

Do të thotë cdo hipotekë, detyrim, garanci, opSION, kufizim, e drejtë për refuzim të parë, e drejtë për parablerje ose e drejtë ose interes tjetër i palës së tretë, barre ose interes i cdo lloji, ose lloj tjetër marrëveshje preferenciale (duke përfshirë, pa kufizim, transferim titulli ose marrëveshje e mbajtjes së titullit) me efekt të ngjashëm;

“Forcë madhore”

nënkupton cdo sanksion të natyrës kombëtare ose ndërkombëtare, kryengritje, rebelim, trazirë civile, luftë (të deklaruar apo të padeklaruar), veprime ose kërcënime për veprime nga terroristë ose grupë guerilë ose individë, zjarre, përmbajtje, tërmete, grevë, ndërprerje, ose cdo shkak tjetër jo për faj apo neglizhencë të Palëve, ose secilit prej tyre, të ngjashme ose jo me sa më sipër, me kusht që cdo shkak i tillë të jetë përtej kontrollit të arsyeshëm të Palës së prekur;

“Miratimet Qeveritare”

nënkupton të gjitha miratimet, pëlqimet, lejet dhe licensat e kërkuara për tu marrë nga Autoritetet Qeveritare në lidhje me transaksionin;

“Autoritet Qeveritar”

nënkupton cdo gjykatë vendase ose të huaj ose cdo autoritet tjetër gjyqësor apo organ, departament, agjensi, komision, autoritet apo instrument qeveritar, administrativ ose rregullator;

“Data e Fundit e Llogarive”

do të thotë 31.12.2017;



- “Humbje” ose “Humbjet” do të thotë cdo dëm, kosto, shpenzim të kryer, pagesë, humbje ose detyrim, të cilat janë pasojë direkte ose indirekte e shkeljes së kësaj Kontrate, në vecanti secilës prej deklaratave dhe garancive të specifikuara në Nenin 5;
- “Palë” ose “Palët” nënkupton Blerësin, të përcaktuar këtu, ose Shitësin ose të dy, sikundër mund të kërkojë konteksti;
- “Cmimi i Blerjes” do të thotë 217,000.00 Euro (dyqind e shtatëmbëdhjetë mijë Euro) për blerjen e Kuotës në Shitje sikundër është shpjeguar në Nenin 3 dhe në përputhje me mekanizmin e përcaktuar këtu;
- “Data Transferimit” nënkupton datën kur Kontrata e Blerjes së Kuotave është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në Shqipëri dhe pronësia mbi Kuotën në Shitje është transferuar nga Shitësi tek Blerësi;
- “Kuota në Shitje” nënkupton 1 kuotë të zakonshme, sikundër është përcaktuar në seksionin Duke qenë se III.;
- “Nënshkrimi” nënkupton nënshkrimin e kësaj Kontrate;
- “Data e Nënshkrimit” nënkupton datën kur kjo Kontratë është nënshkruar midis Palëve;
- “Dokumentat e Transaksionit” nënkupton këtë Kontratë, si dhe cdo amendim ose aneks dhe shtojcë tjetër këtu ose të lidhur me të.
- 1.1 Gjinia mashkullore do të përfshijë gjininë femërore dhe atë asnjansë, si dhe numri njëjës do të përfshijë numrin shumës dhe anasjelltas.
- 1.2 Referencat ndaj “personave” do të përfshijnë organet korporative, shoqëritë e pa-inkorporuara dhe partneritetet (me personalitet ligjor të vecantë ose jo).
- 1.3 Referencat në këtë Kontratë ndaj neneve dhe anekseve janë për nenet dhe anekset e kësaj Kontrate (përvec nëse konteksti kërkon ndryshe). Anekset ndaj kësaj Kontrate do të konsiderohet se përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Kontrate.

- 1.4 Titujt janë vendosur vetëm për lehtësi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e kësaj Kontrate.
- 1.5 Përshkrimet e mësipërme janë të përfshira këtu dhe përbëjnë një pjesë të kësaj Kontrate.
- 1.6 Cdo dispozitë e kësaj Kontrate, e cila shprehet të jetë detyruese për më shumë se një person, përvec nëse konteksti e kërkon ndryshe ose parashikohet shprehimisht ndryshe, do të jetë detyruese për secilin bashkarisht ose vecmas.

NENI 2 BLERJA E KUOTËS NË SHITJE

Sipas dhe në përputhje me afatet dhe kushtet e kësaj Kontrate Shitësi do ti shesë Blerësit dhe Blerësi do të blejë nga Shitësi, Kuotën në Shitje dhe cdo të drejtë që i përket Kuotës në Shitje, pa asnjë Barrë, për Cmimin e Blerjes dhe të pagueshëm në mënyrën e përshkruar këtu.

NENI 3 CMIMI BLERJES DHE METODA E PAGESËS

Cmimi total i blerjes për Kuotën në Shitje është 217,000.00 Euro (dyqind e shtatëmbëdhjetë mijë Euro) ("**Cmimi i Blerjes**") dhe do të paguhet në përputhje me dispozitën këtu dhe sipas kushteve dhe afateve të kësaj Kontrate.

Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, por në cdo rast, jo më vonë se 31 Gusht 2018, Blerësi do të paguajë Cmimin e Blerjes, në llogarinë e Shitësit të përcaktuar nga ky i fundit.

NENI 4 NËNSHKRIMI, REGJISTRIMI NË REGJISTRIN TREGTAR, AUTORIZIMET E TJERA

Blerësi do të pëvetësojë titullin e Kuotës në Shitje në Datën e Transferimit, në momentin që Qendra Kombëtare e Biznesit ka regjistruar transferimin e pronësisë mbi Kuotën në Shitje nga Shitësi të Blerësi.

Palët do të nënshkruajnë dhe dorëzojnë, dhe/ose do të mundësojnë nënshkrimin dhe dorëzimin, të dokumentave të tjera sikundër mund të jetë e nevojshme sipas ligjit shqiptar për të marrë aprovimet qeveritare, sikundër mund të kërkohet, si dhe ato do të regjistrojnë këtë Transaksion dhe Blerësin në regjistrin tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit në Shqipëri, si pronar të ligjshëm të Kuotës në Shitje.

Palët do ti shmangen cdo veprimi, si dhe do të njoftojnë njëri tjetrin menjëherë për cdo zhvillim, që mund të rrezikojë Transaksionin.

Palët do të bashkëpunojnë dhe do të mundësojnë që Shoqëria të bashkëpunojë me Blerësin, ose të veprojë direkt aty ku është e nevojshme ose kërkohet nga cdo ligj i zbatueshëm, në përgatitjen e aplikimit/ve të kërkuara.

NENI 5

DEKLARATAT DHE GARANCITË E SHITËSIT

Shitësi me këtë bën deklaratat dhe garancitë e mëposhtme ndaj Blerësit, secila prej tyre do të jetë e vërtetë dhe e saktë në Datën e Mbylljes.

5.1 ORGANIZIMI

Shitësi nuk është në gjendjen e paaftësisë për të paguar dhe ka fuqi të plotë për të kryer aktivitetin e saj sikundër kryhet aktualisht dhe të zotërojë asetet dhe pasuritë e saj sic i zotëron aktualisht.

5.2 AUTORIZIMI

Të gjitha aktet korporative dhe/ose procedurat e tjera që kërkohen të ndërmerren nga ose në emër të Shitësit për të autorizuar të njëjtin për të lidhur dhe zbatuar këtë Kontratë janë ndërmarrë në mënyrë të rregullt, kjo Kontratë është nënshkruar dhe dorëzuar rregullisht nga Shitësi dhe përbën një detyrim të vlefshëm të Shitësit, të detyrueshëm kundrejt tij, në përputhje me afatet dhe kushtet e saj.

5.3 MOSMARRËVESHJA

Nënshkrimi dhe dorëzimi kësaj Kontrate dhe mbyllja e transaksioneve të parashikuara nga kjo Kontratë dhe në përputhje me afatet, kushtet dhe dispozitat e kësaj Kontrate nga Shitësi nuk do të bie ndesh ose të rezultojë në ndonjë shkelje ose mosplotësim, ose të rezultojë në shkelje të ndonjë ligji apo dokumenti tjetër nga Shitësi që mund të ndikojë vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e kësaj Kontrate.


NENI 6

DEKLARATAT DHE GARANCITË E BLERËSIT

Blerësi me këtë bën deklaratat dhe garancitë e mëposhtme ndaj Shitësit, secila prej tyre do të jetë e vërtetë dhe e saktë në Datën e Mbylljes.

6.1 ORGANIZIMI

Blerësi nuk është në gjendjen e paaftësisë për të paguar dhe ka fuqi të plotë për të kryer aktivitetin e saj sikundër kryhet aktualisht dhe të zotërojë asetet dhe pasuritë e saj sic i zotëron aktualisht. Blerësi do të jetë përgjegjës për pagesën e Cmimit të Blerjes sikundër është përcaktuar në Nenin 3.



6.2 AUTORIZIMI

Të gjitha aktet korporative dhe/ose procedurat e tjera që kërkohen të ndërmerren nga ose në emër të Blerësit për të autorizuar të njëjtin për të lidhur dhe zbatuar këtë Kontratë janë ndërmarrë në mënyrë të rregullt, kjo Kontratë është nënshkruar dhe dorëzuar rregullisht nga Blerësi dhe përbën një detyrim të vlefshëm të Blerësit, të detyrueshëm kundrejt tij, në përputhje me afatet dhe kushtet e saj.

6.3 MOSMARRËVESHJA

Nënshkrimi dhe dorëzimi kësaj Kontrate dhe mbyllja e transaksioneve të parashikuara nga kjo Kontratë dhe në përputhje me afatet, kushtet dhe dispozitat e kësaj Kontrate nga Blerësi nuk do të bie ndesh ose të rezultojë në ndonjë shkelje ose mosplotësim, ose të rezultojë në shkelje të ndonjë ligji apo dokumenti tjetër nga Blerësi që mund të ndikojë vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e kësaj Kontrate.

6.4 DIVIDENTËT

Shitësi njeh dhe pranon se ai nuk do të ketë të drejtë ndaj asnjë dividendi, të fituar para Datës së Nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe se ai heq dorë nga cdo e drejtë për të kërkuar ose pretenduar cdo dividend, ose fitim tjetër të Shoqërisë.

NENI 7 FORCA MADHORE

Dështimi i një Pale oër të përmbushur ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate nuk do të konsiderohet të jetë një shkelje ose mospërmbushje e kësaj Kontrate për sa kohë që ky dështim lind nga një ngjarje e Forcës Madhore, me kusht që Pala e ndikuar nga kjo ngjarje (a) ka marrë të gjitha masat paraprake të arsyeshme, kujdesin e duhur dhe masat alternative të nevojshme në mënyrë për të zbatuar të gjitha afatet dhe kushtet e kësaj Kontrate dhe (b) ka informuar Palën tjetër sa më shpejt të ishte e mundur në lidhje me ndodhinë e kësaj ngjarje.

Cdo periudhë, përgjatë së cilës një Palë, sipas kësaj Kontrate, do të përmbushë cdo veprim ose detyrë do të zgjatet për një periudhë të barabartë me kohën përgjatë së cilës kjo Palë ishte në pamundësi për të kryer këto veprim si rezultat i Forcës Madhore.

NENI 8 NDËRPRERJA E KONTRATËS

Kjo Kontratë mund të ndërpritet vetëm për sa më poshtë:

- a) Me marrëveshje të përbashkët me shkrim midis Shitësit dhe Blerësit sipas datës së përcaktuar këtu; ose
- b) Në rast se Blerësi dështon të paguajë Cmimin e Blerjes, në përputhje me Nenin 3 më sipër, përvec nëse është rënë dakort ndryshe midis Palëve; ose
- c) Palët që dështojnë të marrin cdo Aprovim Qeveritar (nëse kërkohet në mënyrë të detyrueshme) brenda 180 ditëve ("**Afati Fundit**") për arsye që nuk i përkasin atyre, përvec nëse vendosin me shkrim për të shtyrë këtë afat.

NENI 9 LIGJI DHE JURIDIKSIONI ZBATUESHËM

Kjo Kontratë udhëhiqet nga ligjet e Shqipërisë.

Cdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me vlefshmërinë, efektivitetin, interpretimin, zbatimin dhe përfundimin e kësaj Kontrate do të zgjidhet nga gjykata shqiptare kompetente.

NENI 10 TE NDRYSHME

10.1 NDRYSHIMET

Asnjë ndryshim, modifikim, përfundim ose heqje dorë nga ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate nuk do të jetë në asnjë rast efektiv përvec nëse e njëjta do të jetë me shkrim, e nënshkruar nga ose në emër të secilës Palë dhe e noterizuar.

10.2 VLEFSHMËRIA E PJESSHME

Në rast se ndonjë dispozitë ose detyrim sipas kësaj Kontrate do të jetë e pavlefshme, e paligjshme ose e pazbatueshme në cdo juridiksion, vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave ose detyrimeve të mbetura, ose të kësaj dispozite apo detyrimi në cdo juridiksion tjetër, nuk do të ndikohet apo preket në asnjë mënyrë më këtë.

Palët me këtë bien dakort të përpiqen të zëvendësojnë cdo dispozitë të pavlefshme ose të pazbatueshme, e cila, në masën më të gjerë të mundshme, përmbush qëllimet e dispozitës së pavlefshme ose të pazbatueshme.

10.3 KOPJET



Kjo Kontratë mund të nënshkruhet në një ose disa kopje, secila prej tyre kur nënshkruhet dhe dorëzohet do të konsiderohet kopje origjinale, por të gjitha këto kopje së bashku do të përbejnë një dhe të njëjtin dokument; faqet e nënshkruara mund të vecohen nga kopje të shumta të ndara dhe të lidhen me një kopje të vetme në mënyrë që të gjitha faqet e nënshkruara të jenë fizikisht të lidhura me të njëjtin dokument.

Ky dokument është nënshkruar nga palët në gjuhën angleze, shoqëruar me një përkimin të vërtetuar në gjuhën shqipe, për qëllim të regjistrimit të Transaksionit në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Shqipëri. Në rast konflikti midis dy versioneve, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

10.4 NJOFTIMET

Një njoftim ose komunikim tjetër sipas ose në lidhje me këtë Kontratë ("**Njoftimi**") do të jetë:

- me shkrim;
- në gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe;
- dorëzuar ose dërguar me postë të parapaguar të regjistruar Palës për shkak të marrjes së njoftimit në adresën e përcaktuar këtu ose në ndonjë adresë tjetër të specifikuar nga ajo Palë.

Përveç nëse ka provë se është dorëzuar më përpara, një njoftim konsiderohet i dhënë nëse:

- është dorëzuar me E-mail, 10 (dhjetë) Ditë Pune pas postimit; dhe

Adresat e referuara janë:

SHITËSI

Znj. Maria Kannava

Adresa: 3 Markou Botsari Street, Kati 2-të dhe 3-të 3040 Limassol, Qipro

Telefon: +35725585583

Celular: +35799465757

E-mail: m.kannava@kpklegal.com

BLERËSI

Znj. Alexandra Adam



Adresa: kilometri 5-të Varis-Koropiou Avenue 19400 Koropi, Greqi

Telefon: +302106697559

Celular: +306936697559

E-mail: a.adaam@lykos.gr

10.5 TRANSFERIMI

Kjo Kontratë do të jetë detyruese dhe do të jetë vepruese për përfitim të Palëve dhe pasardhësve dhe emëruesve të tyre të lejuar.

Palët nuk mund të caktojnë apo transferojnë asnjë prej të drejtave sipas kësaj Kontrate në terësi apo pjesërisht pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër, pëlqim i cili nuk duhet të refuzohet në mënyrë të paarsyeshme.

10.6 SHPENZIMET DHE TATIMET

Përvec kur kjo Kontratë parashikon ndryshe, secila Palë do të paguajë vetë shpenzimet dhe tatimet në lidhje me negocimin, përgatitjen, nënshkrimin dhe zbatimin e kësaj Kontrate dhe anekseve të saj.

10.7 MARRËVESHJA NË TERËSI

Kjo Kontratë përbën marrëveshjen në terësi dhe zëvendëson cdo marrëveshje të mëparshme midis Palëve në lidhje me objektin e kësaj Kontrate.

SHITËSI

Për Wildermore Holdings Ltd.

Znj. Maria Kannava
[vula/nënshkrimi]

BLERËSI

Për INFORM P. LYKOS S.A.
PROCESSING & DEVELOPMENT
OF PRINTED INFORMATION
SYSTEMS

Znj. Alexandra Adam
[vula/nënshkrimi]



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NR. 528 REP.

Tiranë më 16/10/2018

VËRTETIM

Vërtetohet firma e përkthyesit Znj. Ina Milaqi, vendlindja Durrës dhe banimi në Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e pasaportës me nr. personal J35624069V, e njohur personalisht prej meje Noteres, e cila deklaron se ka përkthyer sa më sipër njëllor me origjinalin nga gjuha Angleze në Shqip dokumentin dhe nënshkroi rregullisht para meje.



NOTERE

RIDVANA RUÇI